

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Lisus by Intermedica” Shpk

Ortakët themelues:

1. **Shoqëria “Intermedica Center” shpk** themeluar me datë 21/05/1996 dhe regjistruar me date 06/03/2003 me numër Nipt K31513084W me adresë kryesore : Njesia administrative nr 9, Rruga Jordan Misja, Zona Kadastrale nr 8330, Nr Pasurie 8/416-N9, 8/416-N7, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Thoma Vasili me numër Karte Identiteti J11124074J, banues në Tiranë
2. **Znj. Mimoza Hafizi** lindur në Shkodër dhe banuese në Lezhë me numër Karte Identiteti 035078338.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 20.02.2023 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin **“Lisus by Intermedica” shpk**

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare **“Lisus by Intermedica” shpk**, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“Lisus by Intermedica” shpk** do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Lezhë, Lagja Besëlidhja afer xhamisë.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare në fushën e shërbime të analizave mikrobiologjike, kimike, hormonale, bakterologjike, molekulare dhe gjenetike.

Ushtrimi aktivitetit diagnostikues dhe kurues, kurimi semundjeve në kushte ambulatorie, organizim të shërbimit të urgjencës. Organizon trajnime profesionale për llogari të vet dhe / ose për llogari të treta.

NENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë **“Lisus by Intermedica” shpk** do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare **“Lisus by Intermedica” shpk** mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë **“Lisus by Intermedica” Shpk** dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8



Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Lisus by Intermedica" Shpk është 1000 (një mijë) lekë.

Ortakët e shoqërisë janë:

1-"Intermedica Center" shpk me Nipt K31513084W është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 40 % të kapitalit të shoqërisë.

2- Znj. Mimoza Hafizi është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 60% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakët e Shoqërisë. Afati i emërimit është 3(tre)vjet. Kompetencat e adminsitrorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është znj.Mimoza Hafizi lindur në Shkoder dhe banuese në Lezhë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me numër karte identiteti 035078338.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

ORTAKËT

E SHOQERISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

"Lisus by Intermedica" Shpk

"Intermedica Center" shpk

Administratori

Thoma Vasili

Thoma Vasili

Thoma Vasili

INTERMEDICA CENTER SHPK
Rr. JORDAN MISJA, TIRANË
NIPT: K 31513084 W
Tel: 22200600 FAX: 2234166

Mimoza Hafizi

Mimoza Hafizi